



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 30 AKTI

NR. 15 VENDIMI

Tiranë, më 20.4.2018

VENDIM

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Pamela Qirko	Anëtare
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Znj. Mia LHE Roessingh-Bakels, më datë 17.04.2018, ora 11:00, në Pallatin e Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Besa Nikëhasani**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit, Shkodër, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë Kushtetuta).

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, Znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, mbështetur në nenin 4/1.a të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidate për anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit”, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (më poshtë referuar si Komisioni).

Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, ka filluar menjëherë pasi janë caktuar me short trupat gjyquese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete, më datë 30.11.2017.

Në mbledhjen e trupës gjyquese të datës 14.12.2017 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupës gjyquese, Znj. Suela Zhegu. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjyquese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit të pasurisë deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa nr. *** prot., datë 13.11.2017, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), me anë të së cilës dërgohej një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ILDKPKI-ja, ka konstatuar se:

- 1) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- 5) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Pas administrimit të raportit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë të subjektit nga ILDKPKI-ja, Komisioni procedoi me hetim të thelluar administrativ, sipas neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, për pasuritë e këtij subjekti dhe ligjshmërinë e burimit dhe krijimit të këtyre pasurive.

Dokumentacioni i analizuar përbëhet nga:

- Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- Provat e depozituara nga subjekti pranë Komisionit;
- Informacionet dhe të dhënat e administruara nga Komisioni nëpërmjet organeve shtetërore, personave fizikë dhe juridikë.
- Shpjegimet dhe deklaratat e subjektit në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, të rezultateve të hetimit administrativ dhe shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja, në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ, e duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, të datës 24.01.2017, me nr. indeksi 1915, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2003 - 2016, në raport me të dhënat e Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar;

c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditetet - gjendjet *cash*;

d) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklarura nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ të thelluar, më datë 13.03.2018, trupa gjyquese, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të njoftojë subjektin e rivlerësimit për kalimin e barrës së provës mbi rezultatet e hetimit administrativ, mbështetur në paragrafin 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit e shfrytëzoi këtë të drejtë, duke marrë një kopje të dokumenteve të dosjes, si dhe rezultatet e hetimit administrativ.

Më datë 03.04.2018, subjekti i rivlerësimit depozitoi shpjegimet dhe provat lidhur me rezultatet e hetimit.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupa gjyquese, më datë 10.04.2018, në prani të përfaqësuesit të vëzhguesve ndërkombëtarë, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

Seanca dëgjimore u zhvillua, sipas njoftimit, më datë 17.04.2018, në orën 11:00 paradite, në përputhje me nenin 20 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 17.04.2018, ora 11:00 paradite, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Kongreseve.

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 10.04.2018. Seanca u zhvillua në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Znj. Mia LHE Roessingh-Bakels.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, shprehu opinionin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Ajo depozitoi pranë Komisionit parashtrimet e saj në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.04.2018, të shoqëruar nga certifikata e pronësisë dhe kartela e pasurisë për pasurinë arë, me sipërfaqe 3009 m², në pronësi të vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. M. N., të cilën e kishte depozituar edhe më parë;
- Dy fatura tatimore shitjeje, përkatësisht nr. ***, datë 20.12.2016, me palë blerëse Znj. A. M., në shumën 150.000 lekë, plus TVSH dhe nr. ***, datë 05.12.2016, me palë blerëse Z. A. M., në shumën 120.000 lekë, plus TVSH. Në të dyja faturat, pala shitëse është bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, Z. A. N., dhe përshkrimi është “Shërbim avokatie”. Këto fatura u vunë për herë të parë në dispozicion të Komisionit, pavarësisht kërkesave të mëparshme nga ana e relatorit.

Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Besa Nikëhasani ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, por shfaq mungesë të etikës profesionale në përfundim të kësaj seance, menjëherë pas dhënies së vendimit nga ana e trupës gjyquese të Komisionit.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017^[1]

[1] “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si

dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 17.04.2018, gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;
- dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur,
- e) faktet e njohura botërisht.

Në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 24.01.2017, subjekti deklaroi këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. Një apartament banimi, me sipërfaqe 144.79 m², rruga “****”, Tiranë, i prenotuar sipas aktmarrëveshjes datë 04.09.2009, me shoqërinë “****”, me vlerë 90.000 euro.

Burimi i deklaruar i krijimit:

a. Kursimet familjare ndër vite deri aktualisht;

b. Kontrata të shitjes së pasurisë së paluajtshme (tokë):

Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.8.2008;

Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.8.2008;

Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.2.2010.

c. Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 7.1 milionë lekë ose 50.000 euro.

Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion fotokopje të:

- Aktmarrëveshje, datë 04.12.2009, lidhur me “****” sh.p.k. (e lidhur jo në prani të noterit);
- Kontratë sipërmarrjeje, datë 04.12.2009 (e lidhur jo në prani të noterit), e cila *nuk është dorëzuar e plotë nga ana e subjektit pasi mungonin faqe* (kontrata e plotë është siguruar nëpërmjet ZVRPP-së Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.01.2018);

dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- Kontrata të shitjes së pasurisë së paluajtshme (tokë): Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.8.2008; Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.8.2008; Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.2.2010.
- Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), nr. ***, “Për dhënien e tokës në pronësi, gjithsej 19 000 m², familjes së Znj. M. N.”
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013.
- Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 7.1 milionë lekë, ose 50.000 euro.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2017, drejtuar 27 bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

“Societe Generale Albania”, me shkresën nr. ***, informon se: *Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, Z. A.N, kanë pasur:*

- *Llogari rrjedhëse individ, në monedhën lekë, mbyllur më datë 24.11.2017.*
- *Kredi me këste për blerje pasurie të paluajtshme me kolateral Hipotekë mbi apartamentin me sipërfaqe 144.79 m², me adresë Rr. “****”, në pronësi të firmës “****” sh.p.k.*

- Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2017, drejtuar bankës “Societe Generale Albania”, në të cilën kërkohet dosja e plotë e kredisë bankare.

Me shkresën nr. ***, banka “Societe Generale Albania” vë në dispozicion dokumentet e kredisë.

- Shkresë nr. *** , datë 18.12.2017, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.

Me shkresën nr. *** prot., datë 11.01.2018, ZVRPP Tiranë informon se: *Subjekti i rivlerësimit ka të regjistruara pasuritë e mëposhtme:*

- *Apartament me sipërfaqe 144.79 m², me nr. pasurie ***;*
- *Garazh me sipërfaqe 21.1 m², me nr. pasurie ***;*
- *Garazh me sipërfaqe 19.2 m², me nr. pasurie ***.*

*Bashkëlidhur përgjigjes, kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol. datë 18.11.2017, të lidhur ndërmjet palës shitëse, shoqërisë “****” (ndryshuar emri nga “****” në “****”) dhe palës blerëse, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.*

- Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2017, drejtuar noterit publik, Z. V.Gj.M.

Më datë 20.12.2017, me shkresë nr. *** prot., noteri publik, Z. V.Gj.M, vë në dispozicion kopje të akteve si më poshtë:

- *Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013;*
- *Kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2008;*

- Kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2008;
- Kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.02.2010.

Njoftimi dhe kalimi i barrës së provës

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar edhe në deklaratimet dhe provat e depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit, trupa vendosi përfundimin e hetimit dhe kalimin e barrës së provës te subjekti.

Duke i dhënë mundësinë ligjore për njohjen me dosjen, subjektit iu vunë në dispozicion rezultatet e këtij hetimi, si më poshtë:

Në lidhje me pasurinë apartament banimi, sip. 144.79 m², Rr. “****”, Tiranë. Pjesa takuese 100%. Vlera 90.000 euro.

Rezulton se:

1. Në Deklaratën e Pasurisë “Vetting” nuk ka deklaruar pronësinë e dy garazheve, me sipërfaqe 21.1 m² dhe 19.2 m².
2. Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013, e shtetas M.N, ku deklaroi se: “[.....] Ka pasur në pronësi të saj një sipërfaqe toke prej 1530 m² dhe 1530 m² në fshatin ***, të komunës ***, Lezhë, të cilat me kontratat e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., dhe nr. *** rep., nr. *** kol., ua ka shitur shtetasve L.H e Gj.H, në çmimin total 752.800 lekë, shumë të cilën ajo e ka marrë sot, më datë 22.08.2013, dhe këtë shumë ia dhuron djalit të saj, Z. A.N....”

nuk është në përputhje me:

- i. Kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2008;
- ii. Kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2008. Nëpërmjet këtyre kontratave, Znj. M.N (vjehera e subjektit deklarues) ka shitur dy pasuri të paluajtshme të llojit arë, me sipërfaqe 1530 m², në vlerën prej 376.400 lekësh secila, shumë e cila është likuiduar në vitin 2008, bazuar në nenin 4 të kontratës, ku parashikohet se: “[...] pala shitëse, Znj. M.N, pranoi se e mori të tërë shumën dhe nuk paraqet asnjë pretendim për të.”
- iii. Deklaratën periodike të Deklarimit të Pasurisë të vitit 2008, në të cilën është deklaruar: Shitur tokë bujqësore 3000 m², në vlerën 750.000 lekë, mbetur 1500 m², në fshatin ***, Lezhë.

Në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti ka deklaruar se kur është kontrolluar, në mars të vitit 2013, nga ana e ILDKPKI-së i është kërkuar një konfirmim noterial nga vjehera për dhënien e këtyre parave. Nëse i referohemi deklaratës noteriale, nuk rezulton të jetë në formën e një konfirmimi për dhënien e parave në vitin 2008, por është në formën e një deklarate likuidimi dhe dhurimi. Në vijim, nëse nga ana e subjektit duhet të provohet dhurimi i shumës së përfituar nga shitja e tokës nga ana e vjehrrës, do të duhej të përfshiheshin edhe të ardhurat e përfituara nga

shitja me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.02.2010, për shumën 502.000 lekë.

3. Për herë të parë deklarohet në vitin 2007 kursime nga pagat me një vlerë prej 300.000 lekësh dhe më pas, vit pas viti, ka deklaruar shtesa dhe pakësime në kursime. Në tabelën e mëposhtme janë të reflektuara diferencat mes gjendjes reale të kursimeve të subjektit dhe gjendjes së deklaruar prej saj nga viti 2007 deri në vitin 2011.

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011
Gjendja në fillim e likuiditeteve (I)	-	300.000	1.675.000	1 575 000	452.620
Shtesa në likuiditete (II)	300.000	1.375.000	1.300.000	1 677 620	8.488.300
Pakësime në likuiditete (III)	-	-	1.400.000	2 800 000	8.733.000
Gjendje reale në fund e likuiditeteve (IV= I+II+III)	300.000	1.675.000	1.575.000	452 620	207.920
Gjendje e deklaruar nga subjekti (V)	300.000	2.000.000	1.885.000	1 155 240	900.000
Diferenca (VI=IV-V)	0	-325.000	-310.000	-702.620	-692.080

Nga analizi i këtyre të dhënave vërejmë se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme diferencat e shumave të deklaruara nga ana e saj si kursime për vitet përkatëse.

Arsyetimi ligjor:

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pronësinë mbi apartament banimi, me sipërfaqe 144.79 m², Rr. “****”, Tiranë. Por, bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 11.01.2018, të ZVRPP-së Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit, përveç apartamentit me sipërfaqe 144.79 m², ka në pronësi edhe:

- Garazh me sipërfaqe 21.1 m², që nuk është deklaruar në Deklaratën e Pasurisë “Vetting” nga ana e subjektit të rivlerësimit;
- Garazh me sipërfaqe 19.2 m², që nuk është deklaruar në Deklaratën e Pasurisë “Vetting” nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit u shpreh në seancën dëgjimore, si edhe në shpjegimet e depozituara pranë Komisionit, se nuk ka pasur për qëllim t’i fshehë apo mosdeklarojë këto dy garazhe. Sipas deklarimit të subjektit: *“Mosdeklarimi i dy posteve të parkimit në Deklaratën “Vetting” është thjesht lapsus apo harresë e bërë pa dashje dhe pa asnjë qëllim”*.

Është e vërtetë se subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të Deklaratës së Pasurisë “Vetting”, ka depozituar pranë ILDKPKI-së aktmarrëveshjen e datës 04.12.2009, lidhur me “****” sh.p.k., në të cilën parashikohet edhe blerja e dy garazheve në çmimin prej 90.000 eurosh, por mbetet fakt se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarimin e tij.

Subjekti i rivlerësimit deklaron si burim për krijimin e kësaj pasurie kontratën e kredisë bankare afatgjatë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.08.2011, lidhur midis shoqërisë Banka “Societe Generale Albania” dhe shtetasve Besa e A.N, në vlerën 7.100.000 lekë dhe afat 240 muaj.

Për këtë kredi është lidhur kontrata e hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.08.2011, midis “****” sh.p.k., dhe bankës “Societe Generale Albania” sh.a., ku në hipotekë është vendosur apartamenti i blerë nga ana e subjektit, i cili, bazuar në certifikatën provizore për regjistrim karabina, datë 26.07.2011, është regjistruar në emër të “****” sh.p.k.

Më datë 14.11.2017, me deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., banka “Societe Generale Albania” deklaron se kredimarrësi ka likuiduar detyrimin ndaj bankës, për pasojë autorizon ZVRPP-në Tiranë të kryejë veprimet e nevojshme për lirimin e pronës së vënë në hipotekë.

Nga analiza e fakteve të mësipërme, rezulton se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij.

Subjekti i rivlerësimit deklaron si burim tjetër për blerjen e këtij apartamenti të ardhurat nga shitja e tokave të vjehrrës (nënës së bashkëshortit A.N, Znj. M.N), në shumën 752.800 lekë, sipas kontratave: *Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2008; Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2008*, si dhe në shumën 502.200 lekë, sipas *Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.02.2010*.

Në lidhje me këto të ardhura, për të provuar se vjehrra i ka dhuruar të ardhurat e siguruara nga shitja e pasurive të paluajtshme, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013, të shtetasës Znj. M.N, e cila deklaron se:

*“Ka pasur në pronësi të saj një sipërfaqe toke prej 1530 m² dhe 1530 m² në fshatin *** të komunës ***, Lezhë, të cilat me kontratat e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol. dhe nr. *** rep., nr. *** kol. ia ka shitur shtetasve L.H e Gj.H në çmimin total 752. 800 lekë, shumë të cilën ajo e ka marrë sot, më datë 22.08.2013, dhe këtë shumë ia dhuron djalit të saj, Z. A.N.”*

Kjo deklaratë noteriale nuk përputhet me dokumentacionin e dorëzuar nga ana e subjektit, si më poshtë:

- i** Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2008;
- ii** Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2008.

Në të dyja këto kontrata konstatohet se neni 4 parashikon se: *“... pala shitëse, Znj. M.N, pranoi se e mori të tërë shumën dhe nuk paraqet asnjë pretendim për të.”*

- iii.** Deklaratën periodike të Deklarimit të Pasurisë së subjektit Besa Nikëhasani për vitin 2008, e cila deklaron: Shitur tokë bujqësore 3000 m², në vlerën 750.000 lekë, mbetur 1500 m² në fshatin *** , Lezhë.

Për sa më sipër, rezulton të kemi mospërputhje midis deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013, dhe dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në lidhje me kohën e marrjes së të ardhurave, pasi referuar kontratave të shitjes dhe deklaratës së interesave private të pasurisë së vitit

2008, rezulton se këto të ardhura janë marrë në vitin 2008, ndërsa referuar deklaratës noteriale ato janë marrë në vitin 2013.

Duke konstatuar këtë mospërputhje, trupa gjyquese e Komisionit iu drejtua subjektit të rivlerësimit për sqarim më datë 30.01.2018.

Subjekti i rivlerësimit, sqaron se:

“Në muajin mars të vitit 2013, kur jam kontrolluar nga ILDKPKI-ja, në pyetjen apo sqarimin lidhur me të ardhurat në shumën 750.000 lekë, të përfituara nga shitja e tokës bujqësore sipas kontratave të sipërcituara, të deklaruara në deklaratën e P/V 2008, më është kërkuar një konfirmim noterial nga vjehrra, e cila figuron shitëse, që ato lekë na i ka dhënë neve (d.m.th., mua dhe bashkëshortit). Në atë kohë, vjehrra ime ka qenë në Itali, te fëmijët e saj, kur ka ardhur në Shqipëri, në muajin gusht 2013, me kërkesën tonë është paraqitur te noteri, për të bërë deklaratën noteriale për këtë fakt. Pra, është e qartë që kjo shumë lekësh është përfituar nga ne, që në momentin e shitjes së kësaj sipërfaqeje tokë.”

Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë çështje, në seancën dëgjimore të datës 17 prill 2018 deklaroi: *“...Kjo shumë, siç edhe është deklaruar gjatë gjithë kohës që në D/V 2008, është përfituar nga ana jonë pikërisht ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, pra më datë 15.08.2008, dhe më datë 22.08.2013, kur është bërë deklarimi i nënës së bashkëshortit për këtë shumë, nga noteri është bërë lapsus, duke u shkruar se kjo shumë është marrë sot...”*

Për të vërtetuar këtë, subjekti ka depozituar edhe një vërtetim të nënshkruar nga noteri publik, Z. V.M, i cili, më datë 27.03.2018, merr përsipër të korrigjojë një “lapsus” të bërë në një dokument noterial të redaktuar prej tij në vitin 2013, duke konfirmuar një veprim të kryer në vitin 2008.

Bazuar në deklaratimet e subjektit, rezulton se deklarata noteriale përmban të dhëna jo të sakta në lidhje me kohën e marrjes së të ardhurave, pasi subjekti pranon që këto të ardhura janë marrë në vitin 2008, por kur është kontrolluar, në mars të vitit 2013, nga ana e ILDKPKI-së i është kërkuar një konfirmim noterial nga vjehrra për dhënien e këtyre parave. Nëse i referohemi deklaratës noteriale, nuk rezulton të jetë në formën e një konfirmimi për dhënien e parave në vitin 2008, ashtu siç pretendon subjekti (për të bërë deklaratën noteriale për këtë fakt), por është në formën e një deklarate likuidimi dhe dhurimi për një periudhë të ndryshme nga ajo që deklarohet nga subjekti, pasi në të parashikohet se *“Znj. M.N ka pasur në pronësi e saj një sipërfaqe toke prej 1530 m² dhe 1530 m² në fshatin *** të komunës ***, Lezhë, të cilat me kontratat e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., dhe nr. *** rep., nr. *** kol., ua ka shitur shtetasve L.H e Gj.H, në çmimin total 752.800 lekë, shumë të cilën ajo e ka marrë sot, më datë 22.08.2013, dhe këtë shumë ia dhuron djalit të saj, Z. A.N.”*

Në vijim të argumentimit të mësipërm, nëse subjekti do të donte të provonte dhurimin e shumës, të përfituar nga shitja e tokës nga ana e vjehrrës, do të duhej të përfshinte edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e një cope toke tjetër me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.02.2010, për shumën 502.000 lekë.

Në këto kushte, konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka përdorur deklaratë të rreme për të justifikuar me burim të ligjshëm të ardhurash pasurinë e blerë, apartament, sip. 144.79 m², me adresë Rr. “***”, Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit deklaron si burim tjetër për blerjen e këtij apartamenti kursimet familjare ndër vite deri aktualisht.

Duke marrë të mirëqena deklaratimet e subjektit, rezulton se çmimi i kësaj pasurie është 90.000 euro, i konvertuar në lekë me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2009, llogaritet në shumën 12.345.300 lekë. Nga kjo shumë, 7.100.000 lekë janë përballuar nga kredia e marrë në SGA, 1.254.800 lekë janë përfituar nga shitja e tokave, ndërsa diferenca prej 3.990.500 lekësh duhet të jenë kursimet familjare ndër vite.

Këto kursime familjare duhet të jenë realizuar nga viti 2004 (viti ku sipas deklaratimit të subjektit kanë përfunduar punimet në apartamentin në Rr. “***”, Lezhë, Deklarata e Pasurisë e vitit 2004) deri në vitin 2010, kur ka paguar këstin e fundit kundrejt “***” sh.p.k., në shumën 10.000 euro (përveç kredisë 50.000 euro).

Subjekti, për herë të parë deklaron në vitin 2007 kursime nga pagat me një vlerë prej 300.000 lekësh dhe më pas, vit pas viti, ka deklaruar shtesa dhe pakësime në kursimet e saj. Në tabelën e mëposhtme janë të reflektuara diferencat mes gjendjes reale të kursimeve të subjektit dhe gjendjes së deklaruar prej saj nga viti 2007 deri në vitin 2011.

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011
Gjendja reale në fillim të vitit e të ardhurave (kursimeve) Lekë	-	300.000	1.675.000	1.575.000	452.620
Shtesa në të ardhurat sipas deklarimeve në deklaratat periodike vjetore të subjektit Lekë	300.000 (kursime nga paga e bashkëshortit të subjektit)	1.375.000 a. 625.000 lekë shtesë në kursimet nga të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit b. 750.000 lekë shtesë në të ardhurat nga shitja e 3.000 m ² tokë në fshatin ***	1.300.000 a. 1.300.000 lekë shtesa në të ardhurat e kursyera gjatë vitit 2009	1.677.620 a. 1.400.000 lekë shtesa në të ardhurat e kursyera gjatë vitit 2010 b. 2.000 euro ose 277.620 lekë shtesa në të ardhurat e kursyera gjatë vitit 2010	8.488.300 a. 1.250.000 lekë shtesa në të ardhurat e kursyera gjatë vitit 2011 b. 1.000 euro ose 138.300 lekë shtesa në të ardhurat e kursyera gjatë vitit 2011 c. 7.100.000 lekë marrje kredie për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë ndërtuese “***”

					8.733.000 a. Pakësime në vlerën 7.100.000 lekë ose 50.000 euro për shlyerjen e detyrimit total shoqërisë ndërtuese "***"
Pakësime në të ardhurat sipas deklarimeve në deklaratat periodike vjetore të subjektit Lekë	-	-	1.400.000 a. pakësime në vlerën 10.000 euro, ose 1.400.000 lekë për të paguar detyrimin ndaj shoqërisë ndërtuese "***"	2.800.000 a. pakësime në vlerën 20.000 Euro ose 2.800.000 lekë për blerjen e apartamentit të banimi me sip. 87 m ² në Shëngjin, me vlerë 28.000 euro	b. Pakësime në vlerën 250.000 lekë për shlyerjen e detyrimit ndaj Bankës "Societe Generale" për kreditë për blerje shtëpie c. Pakësime në vlerën 10.000 euro ose 1.383.000 lekë për shlyerjen e detyrimit total shoqërisë ndërtuese "***"
Gjendje në fund të vitit e të ardhurave (kursimeve) Lekë	300.000	1.675.000	1.575.000	452.620	207.920
Gjendje e deklaruar nga subjekti i të ardhurave (kursimeve në fund të vitit) Lekë	300.000	2.000.000	1.885.000	1.155.240	900.000
Diferenca (VI=IV-V)	0	-325.000	-310.000	-702.620	-692.080

Në shpjegimet e saj, subjekti nuk bie dakord me përlllogaritjet e bëra nga ana e Komisionit, specifikisht në vitin 2008 dhe 2010.

Në lidhje me vitin 2008, subjekti pretendon se: *“Kursimet gjatë vitit 2008, në shumën 950.000 lekë, janë si rezultat i të ardhurave tona, nga paga ime 123.000 lekë, nga paga e bashkëshortit 925.000 lekë dhe nga pensioni i nënës së bashkëshortit, 100.000 (njëqind mijë) lekë, si dhe nga fakti që gjatë këtij viti nuk kemi pasur shpenzime të tjera, përveç atyre për nevoja familjare (pra për jetesë).”*

Nga verifikimi i Formularit të Vetëdeklarimit të Pasurisë, për vitin 2008, konstatohet se vetë subjekti ka deklaruar si kursime nga të ardhurat e bashkëshortit shumën prej 625.000 lekësh, plus kursimet e vitit 2007, në shumë prej 300.000 lekësh, në total 925.000 lekë, ndërsa në po të njëjtën deklaratë, subjekti deklaroi se ka pasur kursime për këtë vit në shumën 950.000 lekë, duke harruar që shumën prej 300.000 lekësh e ka llogaritur një herë si të ardhur. Në shpjegimet në seancë, subjekti vazhdon ta llogarisë këtë shumë për herë të dytë, duke rritur kështu në mënyrë fiktive kursimet e vitit 2008. Dhe kjo rritje fiktive vazhdon të reflektohet edhe në vitet në vijim.

Nga ana tjetër, subjekti deklaroi si shpenzime për nevoja familjare në shumën 1.305.000 lekë, që pjesëtuar me 12 muaj, rezulton shuma prej afërsisht 108.750 mijë lekë në muaj. Duke marrë në konsideratë faktin që subjekti i rivlerësimi ka tre fëmijë dhe se vjehrra jeton me familjen e saj, ndërkohë që vetë subjekti jeton në Tiranë dhe punon në Shkodër, duke pasur shpenzime transporti

dhe ushqimi, nisur nga niveli dhe kostoja e jetesës në zonën e saj të banimit, mund të lindin dyshime të arsyeshme nëse kjo shumë është e mjaftueshme për të përballuar jetesën.

Nga analizimi i të dhënave të mësipërme vërejmë se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme diferencat e shumave të deklaruara nga ana e saj si kursime për vitet përkatëse.

Në këto kushte, konstatohet se subjekti nuk ka pasur mundësi të kursejë, as familjarisht, shumë prej 3.990.500 lekësh, për t'i përdorur për blerjen e apartamentit në Rr. "****", Tiranë, pasi nuk justifikon me të ardhura të ligjshme shumë prej 2.019.700 lekësh.

Në përfundim të kësaj analize, vërehet se subjekti i rivlerësimit:

(i) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë:

- Apartament me sipërfaqe 144.79 m², me nr. pasurie ***;
- Garazh me sipërfaqe 21.1 m², me nr. pasurie ***;
- Garazh me sipërfaqe 19.2 m², me nr. pasurie ***, me adresë në Rr. "****", Tiranë.

(ii) Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë për të ardhurat, me qëllim justifikimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme.

2. Shtëpi banimi me sipërfaqe 76 m², kompleksi "****", ap. ***, Shëngjin, Lezhë, prenotuar sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.5.2010, me vlerë 28 000 euro.

Burimi i deklaruar i krijimit:

a. 25.000 euro, marrë nga shoqëria "****" sh. p. k., me mandat pagese nr. ***, datë 14.5.2010, sipas aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol, datë 17.3.2011, për prishjen e pallatit në Lezhë, ku subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur në pronësi një apartament me sipërfaqe 130 m², i blerë në vitin 1998, me vlerë 1.500.000 lekë, i papërfunduar, me burim të ardhurat nga shitja e shtëpisë së përbashkët me 1.380 m² tokë në fshatin *** në Lezhë, në vitin 1998, me vlerë 1.500.000 lekë, sipas kontratës nr. *** rep., datë 16.09.1998;

b. 3.000 euro kursime nga të ardhurat familjare të vitit 2009.

Si dhe:

3. Njësi shërbimi, plus sipërfaqet e përbashkëta 150 m², në unazën e qytetit Lezhë, Rr. "****", kati ***, përftuar sipas aktmarrëveshjes me shoqërinë "****" sh. p. k., nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.03.2011, për prishjen e pallatit Lezhë.

Për këto dy pasuri, që kanë të njëjtin burim, subjekti ka vënë në dispozicion fotokopje të:

- Kontratë porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.5.2010, të lidhur ndërmjet "****" sh.p.k., dhe shtetasve A. e Besa Nikëhasani.

- Aktmarrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol, datë 17.3.2011, të lidhur ndërmjet “****” sh.p.k. dhe Z. A.N.
- Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 10.07.2013, të lidhur ndërmjet “****” sh.p.k., shtetasve dhe A. e Besa Nikëhasani.
- Aktmarrëveshje për shitjen e një banese dhe toke nr. *** rep., datë 16.09.1998, të lidhur ndërmjet A. dhe Besa Nikëhasanit, si palë shitëse dhe Z. N.Gj, si palë blerëse.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit

- Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2017, drejtuar noterit publik, Z. V.M.

Më datë 20.12.2017, me shkresën nr. *** prot., noteri publik, Z. V.M, vë në dispozicion kopje të akteve si më poshtë:

- *Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.05.2010;*
- *Aktmarrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.03.2011.*

- Shkresë nr. *** , datë 15.12.2017, dërguar ZVRPP-së Lezhë.

Me shkresën nr. *** , datë 22.12.2017, ZVRPP Lezhë informon se:

Nuk ka pasuri të paluajtshme në emër të subjektit dhe personave të lidhur. Përgjigjja e ZVRPP-së Lezhë është e pasaktë, pasi nga të dhënat e deklaruara nga vetë subjekti, por edhe nga shkresa e ZVRPP-së Lezhë, nr. *** prot., datë 28.09.2017, drejtuar ZQRPP-së, rezulton se subjekti ka pasur pasuri të regjistruara në ZVRPP-në Lezhë.

- Në vijim të shkresës nr. *** prot., datë 22.12.2017, i jemi drejtuar sërish ZVRPP-së Lezhë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2017.

Me shkresën nr. *** prot., datë 17.01.2018, të ZVRPP-së Lezhë rezulton se: *Z. A.N dhe Znj. Besa Nikëhasani kanë në pronësi:*

- *Një apartament me sipërfaqe 76 m², të ndodhur në qytetin e Shëngjinit;*
- *Një njësi shërbimi me sipërfaqe 150 m².*

Znj. M.N ka në pronësi:

- *Tokë arë me sipërfaqe 3009 m².*

- Shkresë nr. *** prot., datë 09.01.2018, drejtuar “****” sh.p.k.

Me shkresë pa numër dhe pa datë, “****” sh. p. k. vë në dispozicion:

- *Aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet “****” sh.p.k. dhe Z. A.N;*
- *Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.07.2013, të lidhur ndërmjet “****” sh.p.k. dhe A. e Besa Nikëhasani;*
- *Aktmarrëveshje të ngjashme të lidhura ndërmjet “****” sh.p.k. dhe banorëve të tjerë të atij pallati.*

➤ Dëshmia e Z. P.C, më datë 23.02.2018.

Njoftimi dhe kalimi i barrës së provës

Në përfundim të hetimit administrativ të thelluar, bazuar edhe në deklaratimet dhe provat e depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit, trupa vendosi përfundimin e hetimit dhe kalimin e barrës së provës te subjekti. Duke i dhënë mundësinë ligjore për njohjen me dosjen, subjektit iu vunë në dispozicion rezultatet e këtij hetimi, si më poshtë:

Në lidhje me pasurinë shtëpi banimi, me sipërfaqe 76 m², kompleksi “****”, ap. ***, Shëngjin, Lezhë, prenotuar sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.05.2010, me vlerë 28.000 euro, me pjesë takuese 100%.

Rezultoni se:

1. Për pasurinë apartament në Rr. “****”, Lezhë, ka mospërputhje midis deklaratimit në Deklaratën periodike të vitit 2004 dhe deklaratimit të kryer në Deklaratën e Pasurisë “Vetting” dhe deklarimeve të kryera në Komision gjatë hetimit administrativ në lidhje me elementet e mëposhtme:
 - *Sipërfaqja e deklaruar në vitin 2004 është 90 m², ndërsa në vitin 2017, për arsye të panjohura, kjo sipërfaqe ndryshon në 130 m².*
 - *Vlera e deklaruar në vitin 2004 është 3.700.000 lekë, ndërsa në vitin 2017 vlera e deklaruar është 1.500.000 lekë.*
 - *Viti i blerjes në vitin 2004 deklarohet 2001, ndërsa në vitin 2017 viti i blerjes deklarohet viti 1998, ndërsa në përgjigjet e pyetësorit të dytë deklarohet 1999 dhe më pas sërish deklarohet 1998.*
 - *Burimi i të ardhurave në vitin 2004 deklarohen të ardhura nga kursime dhe ndihma e vëllezërve të bashkëshortit në emigracion dhe shitja e disa tokave, për të cilat nuk është dorëzuar dokumentacion provues*
2. Ka mungesë dokumentacioni ligjor lidhur me burimin e të ardhurave në shumën 2.100.000 lekë për punimet e pretendura të kryera në apartamentin në Rr. “****”, Lezhë. Kjo shumë nuk është deklaruar në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”, si e ardhur e përfituar ndër vite. Nuk u vu në dispozicion asnjë dokument zyrtar mbi mënyrën e lëvrimit dhe përfitimit të shumës.
3. Nuk është dorëzuar asnjë dokument provues për të vërtetuar pronësinë e apartamentit të ndodhur në Rr. “****”, Lezhë, apartament i deklaruar si burim për pasuritë e tjera të paluajtshme në qytetin e Lezhës.
4. Nga ana e subjektit, çdo kontratë shitjeje e kryer nga personat e tjerë të lidhur përdoret si burim të ardhurash, pavarësisht faktit nëse këto të ardhura janë marrë realisht nga ana e tij.
5. Më datë 20.02.2018, është deklaruar se “*Kuptohet që është shitur gjithë sipërfaqja e tokës që kemi përfituar si familje.*” Ky deklarim nuk është në përputhje me të dhënat e marra nga ZVRPP Lezhë, më datë 17.01.2018, nga ku rezultoni se vjehrra e subjektit, Znj. M.N, ka ende në pronësi 3009 m² tokë arë.

6. Në lidhje me shumën 25.000 euro, subjekti ka deklaruar se e ka përfituar në bazë të aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.03.2011, të lidhur ndërmjet “****” sh.p.k. dhe bashkëshortit të subjektit, Z. A.N.

Kemi një mospërputhje midis deklaramit të subjektit dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, nga ku rezulton se, referuar mandatit të pagesës nr. ***, datë 14.05.2010, ku shkruhet tekstualisht: “*paguar për prishjen e apartamentit sipas marrëveshjes së nënshkruar*” dhe Deklaratës periodike të vitit 2010, në të cilën deklarohet: “*të ardhura nga aktmarrëveshja për prishjen e apartamentit të banimit në Lezhë me “****” sh.p.k. 25.000 euro, lëvruar me mandat pagese 14.05.2010*”, kjo aktmarrëveshje rezulton e lidhur që në vitin 2010.

Në lidhje me pasurinë njësi shërbimi, plus sipërfaqet e përbashkëta 150 m², në unazën e qytetit Lezhë, rruga “****”, kati ***.

Rezultun se:

Referuar deklaratave periodike të vitit 2010 dhe 2011, njësia e shërbimit nuk është deklaruar nga ana e subjektit.

Arsyetimi ligjor:

Në Deklaratën e Pasurisë për efekt të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit deklaron si pasuri njësi shërbimi, plus sipërfaqet e përbashkëta 150 m², në unazën e qytetit Lezhë, Rr. “****”, kati ***, si dhe shtëpi banimi me sipërfaqe 76 m², kompleksi “****”, ap. ***, Shëngjin, Lezhë. Subjekti deklaron se ka përfituar këtë njësi shërbimi, si dhe shumën prej 25.000 eurosh nga shoqëria “****” sh.p.k., në zbatim të aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.03.2011, për prishjen e pallatit në Lezhë, ku kanë pasur në pronësi një apartament me sipërfaqe 130 m², i blerë në vitin 1998, me vlerë 1.500.000 lekë, i papërfunduar, me burim të ardhurat nga shitja e shtëpisë së bashku me 1.380 m² tokë në fshatin *** në Lezhë, në vitin 1998, me vlerë 1.500.000 lekë, sipas kontratës nr. *** rep., datë 16.09.1998.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti, si dhe hetimi i Komisionit, rezulton se Z. A. dhe Znj. Besa Nikëhasani kanë pasur në pronësi tokë 1380 m² dhe banesë njëkatëshe, mbi këtë tokë, të cilën me kontratën nr. *** rep., datë 16.09.1998, e kanë shitur në shumën 1.500.000 lekë te pala blerëse, Z. N.Gj. Me këtë shumë, subjekti pretendon se ka blerë nga Z. P.C një apartament (karabina) 90 m² (130 m²), në Rr. “****”, Lezhë.

Deklarimi i subjektit në lidhje me ligjshmërinë e burimit të shumës 1.500.000 lekë është i saktë.

Në Deklaratën periodike të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi pallatin *** në Rr. “****”, Lezhë, por nuk e ka deklaruar fare këtë si pasuri. Në vitin 2003, subjekti ka deklaruar vetëm pronësinë mbi një makinë tip “Golf 1.4”, model 3, prodhim i vitit 1993. Në faqen e parë të këtij formulari, në pjesën përmbledhëse të formularëve, subjekti ka klikuar mbi kutinë “jo” në lidhje me pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale me to.

Në shpjegimet e depozituara në seancën dëgjimore, subjekti pretendon se “...në D/V 2003 kam pasur perceptimin se duhej deklaruar vetëm paga dhe kjo është arsyeja që shtëpinë, tokën dhe automjetin, të cilat kanë qenë pasuri të deklaruara më parë, i kam deklaruar në vitin 2004, pra në D/V 2004.”

Nga analiza dhe krahasimi i të dhënave të deklaruara në vitin 2003 dhe deklarimit të subjektit në pyetësor dhe seancë dëgjimore, konstatohet se subjekti ka qenë krejtësisht i qartë në mënyrën e plotësimit të formularit, përderisa ka deklaruar pronësinë mbi makinën tip “Golf”, por nuk ka deklaruar as pronësinë dhe as të drejtat reale mbi apartamentin në Rr. “****”, Lezhë, duke kryer fshehje të pasurisë që në deklarimin e parë.

Pretendimi i subjektit se “... deklaratat e pasurisë në fillimet e tyre nuk janë plotësuar me kaq përgjegjësi dhe saktësi, pasi në atë kohë nuk kemi pasur as informacionin e duhur për këtë.” nuk mund të justifikojë veprimet e një prokurori me eksperiencë pune thuajse dhjetëvjeçare.

Në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me apartamentin në Rr. “****”, deklaron si më poshtë:

“Shtëpi banimi 90 m², me vlerë 3.700.000 lekë, e cila është blerë në vitin 2001 karabina. Burimi: Kursime ndër vite dhe ndihma e vëllezërve të bashkëshortit nga emigracioni.

Në vitin 2002 kryer punime në vlerën 1.000.000 lekë, të përfituara nga shitja e një toke, sipas kontratës përkatëse. Këto të ardhura nuk janë deklaruar në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”.

*Në vitin 2003, ka kryer sërish punime me vlerë 1.100.000 lekë me të ardhura nga shitja e një toke në ***, Lezhë. Këto të ardhura nuk janë deklaruar në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”.*

Në vitin 2004, ka përfunduar shtëpinë me të ardhura nga shitja e një pjese tjetër toke.” Këto të ardhura nuk janë deklaruar në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”.

Deklarimi i mësipërm, i kryer nga ana e subjektit në vitin 2004, nuk përputhet me Deklaratën e Pasurisë “Vetting” të subjektit në lidhje me elementet e mëposhtme:

- Sipërfaqja e deklaruar në vitin 2004 është 90 m², ndërsa në vitin 2017 sipërfaqja është 130 m².
- Vlera e deklaruar në vitin 2004 është 3.700.000 lekë, ndërsa në vitin 2017 vlera e deklaruar është 1.500.000 lekë.
- Viti i blerjes në vitin 2004 deklarohet 2001, ndërsa në vitin 2017 viti i blerjes deklarohet viti 1998.
- Si burim i të ardhurave në vitin 2004 deklarohen të ardhura nga kursimet dhe ndihma e vëllezërve të bashkëshortit në emigracion, si dhe shitja e disa tokave, për të cilat nuk është dorëzuar dokumentacion provues për marrjen e këtyre shumave, të vetmet toka të shitura rezultojnë tokat e vjehrrës, të cilat janë shitur në vitin 2008 dhe 2010 dhe janë përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, referuar deklaratës së subjektit të rivlerësimit.

Bazuar në kontratën e shitblerjes nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 25.02.2004, rezulton se familjarët e subjektit kanë shitur një pjesë tjetër të tokës arë për shumën 100.000 lekë. Gjatë hetimit

administrativ, marrja e kësaj shume është mohuar nga subjekti, duke deklaruar se të ardhurat nga kontrata e shitjes e vitit 2004 kanë shkuar në favor të kumatit të saj, Z. P.N, por në Deklaratën periodike të vitit 2004 subjekti deklaroi vlerën e apartamentit 3.700.000 lekë dhe se kjo shumë është e përfshirë në këtë vlerë.

Duke u nisur nga deklarimi i subjektit në vitin 2004, sipas të cilit ky apartament është blerë si karabina në shumën 1.500.000 lekë dhe më pas u përfundua duke kryer punime vit pas viti, me të ardhurat nga shitja e tokave, subjektit iu kërkua të provonte me dokumentacion pronësinë mbi këtë apartament, si dhe mbi tokat e shitura, të ardhurat e të cilave kanë shërbyer për kryerjen e punimeve në këtë apartament.

Subjekti përgjigjet kështu: *“Lidhur me këtë pyetje, deklaroi nën përgjegjësinë time ligjore se apartamenti është ndërtuar dhe ardhurat me të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës në *** , të pjesës takuese të nënës së bashkëshortit tim*

*... Ndërsa deklarimi për vitin 2004 është pasaktësi e imja (jona), pasi kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.02.2004, së bashku me deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.10.2002, me palë shitëse të njëjtë, pra nëna e bashkëshortit, kunati P. dhe kunata F., kanë shkuar për llogari të tyre, pra është shitur si pjesë takuese e tyre dhe kuptohet edhe të ardhurat e përfituara nga këto kontrata shitjeje kanë shkuar në favor të tyre. ...Pra theksoj që, deklarimi për kontratën e shitjes të vitit 2004 është i pasaktë dhe ka qenë i panevojshëm...*

Ky deklarim ka qenë i pashoqëruar me kontratat përkatëse, unë thjesht i kam parë të tria këto kontrata dhe i kam deklaruar njëherësh, duke menduar se janë shitur për llogarinë tonë, por e vërteta është që kontrata e shitjes e vitit 2004, e sipërcituar, ka shkuar në favor të kumatit tim, Z. P.N.”

Për të dokumentuar veprimet e kryera në vitet 2002 dhe 2003, subjekti na vë në dispozicion një deklarim noterial, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.02.2018, të bërë përpara noterit, Z. K.Gj. M, në Montecatini Terme, Pistoja, Itali, me palë deklaruese, Znj. M.N, Z. P.N dhe Znj. F.Sh, të cilët deklarojnë përpara noterit, duke legjitimuar veprimet e kryera në vitin 2002, 2003, se i kanë dhuruar bashkëshortit të subjektit shumat e mësipërme.

Pa u thelluar në vlerën e këtij dokumenti noterial, i cili është hartuar nga një noter shqiptar në territorin e Italisë, pa u ndjekur hapat e domosdoshëm zyrtarë për legalizimin e tij, në pikëpyetje vihet vlera e vetë deklarimit. Komisioni arrin në përfundimin se noteri nuk ka bërë gjë tjetër, përveçse ka regjistruar atë që kanë thënë palët, pa qenë në gjendje të dallojë nëse kjo ishte e vërteta. Për këtë arsye, Komisioni vlerëson se ky dokument nuk ka vlerë të dukshme.

Në deklarimin e tij, subjekti pranon që ka dhënë deklarim të pasaktë për kontratën e shitjes së vitit 2004, duke na informuar se ka qenë i panevojshëm për sa kohë me shumën e shitjes së dy kontratave të tjera mbulohen pothuajse të gjitha shpenzimet për apartamentin e ndodhur në Rr. “****”, Lezhë. Bazuar në deklaratën e subjektit, të krijohet bindja mbështetur në prova se çdo kontratë shitjeje e kryer nga personat e tjerë të lidhur të subjektit përdoret si burim të ardhurash nga subjekti, pavarësisht faktit nëse këto të ardhura janë marrë realisht nga ana e tij.

Duke analizuar përgjigjen e subjektit, si dhe deklaratën e familjarëve të tij, mund të gjykojmë se një deklaratë e bërë në kushtet e urgjencës, dy ditë përpara se t'i kthehet përgjigje Komisionit, duke mos vënë në dispozicion asnjë dokument zyrtar të mënyrës së lëvrimit dhe përfitimit të shumës nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, nuk mund të jetë një provë e besueshme.

Gjithashtu, në vijimësi të argumentimit të mësipërm, subjekti, në bazë të ligjit nr. 84/2016, kishte detyrimin të deklarojë të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë. Në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”, shuma prej 2.100.000 lekësh nuk rezultojnë të deklaruara nga ana e subjektit si të ardhura të akumuluar ndër vite, duke përbërë fshehje të pasurisë dhe mungesë dokumentacioni ligjor për justifikimin e burimit të ligjshëm të ardhurave.

Nisur nga akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), nr. ***, rezultojnë se familjes së Znj. M.N i janë dhënë 19.000 m² tokë bujqësore. Bazuar në certifikatën familjare nr. ***, të datës 06.02.2018, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, më datë 8.02.2018, rezultojnë se në bazë të regjistrimit themelitar të vitit 1974, ***, fleta 117, me referencë vërtetohen të dhënat e mëposhtme për gjendjen familjare në datën 01.08.1991 të Znj. M.N: *M.N, P.N, D.N, A.N*.

Në bazë të VKM-së nr. 255, datë 2.8.1991, "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", ku parashikohet se: *“Përfitues i tokës në pronësi është familja bujqësore sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991.”*, rezultojnë se për sipërfaqen 19.000 m² kanë qenë bashkëpronarë të katër personat e sipërpërmendur.

Bazuar në kontratat e shitblerjes të nënshkruara nga personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, konstatohet se janë shitur në total 17.506 m² për shumën 6.930.000 lekë.

Subjekti deklaron më datë 20.02.2018 se *“Kuptohet që është shitur gjithë sipërfaqja e tokës që kemi përfituar si familje.”*

Ky deklaram i subjektit nuk është në përputhje me të dhënat e marra nga ZVRPP Lezhë, më datë 17.01.2018, nga ku rezultojnë se Znj. M.N ka ende në pronësi 3009 m² tokë arë.

Në lidhje me këtë fakt, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti jep këtë shpjegim: *“Kjo sasi toke prej 3009 m² është shitur për llogari të kunetërve, në shumën 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) euro, sipas deklarimeve të tyre, por që letrat nuk qenkan bërë akoma, gjë për të cilën jam vënë në dijeni pas rezultatit të hetimit të kryer nga ana Juaj, ku rezultonte se në pronësi të nënës së bashkëshortit ishin edhe 3009 (tremijë e nëntë) m² tokë.”*

Nga kjo analizë rezultojnë se subjekti i rivlerësimit:

- ✓ **Nuk ka pasur burime të mjaftueshme të ardhurash për të përfunduar ndërtimin e apartamentit në Rr. “****”, Lezhë, në shumën prej 3.60. 000 lekësh;**
- ✓ **Ka kryer deklaram të rremë në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave, në shumën prej 2.100.000 lekësh, si dhe fshehje të kësaj shume në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”.**

Duke vazhduar më tej analizën, ky apartament është shkëmbyer nga subjekti me 25.000 euro dhe një njësi shërbimi 150 m². Shuma prej 25.000 eurosh është përdorur për të blerë apartamentin me sipërfaqe 76 m², kompleksi “****”, ap. ***, Shëngjin, Lezhë.

Në lidhje me këtë, më datë 31.01.2018, subjektit iu kërkua të vinte në dispozicion të Komisionit kontratat e fitimit të pronësisë së këtij apartamenti, si dhe certifikatat e pronësisë. Në përgjigjen e tij, subjekti pretendon se: *“Ky apartament, ashtu si të gjithë banorët apo blerësit e tjerë (edhe 7 të tillë), është blerë **pa kontratë noteriale**, siç edhe kemi sqaruar nga deklaratimet e mëparshme. Pra, as ne dhe asnjë banor tjetër aty, nuk ka patur kontratë blerjeje dhe kuptohet as fitimi të pronësisë apo ta ketë patur të regjistruar në hipotekë.”*

Të njëjtin qëndrim subjekti mban edhe në shpjegimet e tij në seancën dëgjimore, duke sqaruar se “nuk kemi disponuar dokument ligjor (kontratë noteriale shitblerjeje apo certifikatë regjistrimi) për të provuar pronësinë e këtij apartamenti, të ndodhur në Rr. “****”, i prishur tashmë.”

Nga përgjigjet e subjektit, rezulton se për apartamentin që e ka shkëmbyer me aktmarrëveshje nuk ka dorëzuar asnjë dokument provues për të vërtetuar pronësinë e këtij apartamenti, çmimin e shitjes dhe sipërfaqen reale të këtij apartamenti.

Pavarësisht faktit se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur asnjëherë një dokument ligjor që të provojnë pronësinë mbi këtë apartament, me aktmarrëveshjen nr. *** rep., nr *** kol., datë 17.03.2011, subjekti ka këmbyer këtë shtëpi banimi me një shumë prej 25.000 eurosh dhe një njësi shërbimi me sipërfaqe 150 m², vlera e deklaruar e së cilës është 6.000.000 lekë.

Sipas kësaj aktmarrëveshjeje, palët deklarojnë:

*“Në vitin 2010 ka patur **një marrëveshje paraprake me gojë** me të gjithë pronarët e ndërtesës për të prishur një pallat, ku pjesë e kësaj marrëveshjeje ka qenë dhe apartamenti i Z. A.N. Në bazë të kësaj **marrëveshjeje verbale**, subjekti “****” sh.p.k. ka paguar shumën 25.000 euro në favor të Z. A.N me mandat pagese cash.”*

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti, por dhe në dokumentacionin e mbledhur gjatë hetimit administrativ, rezulton se kjo aktmarrëveshje përmban të dhëna të rreme, pasi referuar mandatit të pagesës nr. 20, datë 14.05.2010, ku thuhet tekstualisht: *“paguar për prishjen e apartamentit sipas **marrëveshjes së nënshkruar**”* dhe Deklaratës periodike të vitit 2010, në të cilën subjekti, Znj. Besa Nikëhasani, deklaron: *“të ardhura nga aktmarrëveshja për prishjen e apartamentit të banimit në Lezhë me “****” sh.p.k. 25.000 euro, lëvruar me mandat pagese 14.05.2010”, kjo aktmarrëveshje rezulton e lidhur që në vitin 2010.*

Nga analiza e këtyre provave rezulton se subjekti i rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, nuk arrin të provojë me dokument ligjor pronësinë mbi apartamentin në Rr. “****”, Lezhë. Por, pavarësisht se subjekti nuk ka pasur pronësinë ligjore, të vërtetuar me dokument zyrtar, mbi këtë apartament, ajo e ka shkëmbyer atë me një njësi shërbimi me sipërfaqe 150 m², si dhe me shumën prej 25.000 eurosh, shumë kjo e përdorur nga subjekti për blerjen e apartamentit tjetër prej 76 m², kompleksi “****”, ap. ***, Shëngjin, Lezhë.

Duke analizuar dispozitat ligjore të Kodit Civil, vërejmë se neni 83¹ ka formalizuar veprimin juridik të kalimit të pronësisë mbi sendet e paluajtshme, ndërsa nenet 164² e 195³ të po këtij Kodi përcaktojnë në mënyrë të detajuar pasojat e formalizimit të kalimit të pronësisë për pasuritë e paluajtshme, si dhe pasojat e regjistrimit ose të mosregjistrimit të kësaj pasurie. Ndërsa Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me Vendimin nr. 1, datë 06.01.2009, në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, kanë konkluduar: “...Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, përfituesi i të drejtave bëhet pronar i pasurisë së paluajtshme dhe ky legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundrejt të tretëve, përveç tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në favor të të tretëve”. Më tej, në këtë vendim, Gjykata shprehet: “Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës, duke fituar edhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri”.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ai i grumbulluar gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton në asnjë moment që subjekti dhe bashkëshorti i saj të kenë lidhur ndonjë kontratë të tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme me Z. P.C, në mënyrë që të bëhen pronarë të apartamentit në Rr. “****”. Ky fakt pranohet edhe nga vetë subjekti në përgjigjet e pyetësorit.

Ndërkohë, bazuar në dokumentacion, si dhe në deklaratimet e subjektit, kjo e fundit, së bashku me bashkëshortin, janë sjellë si pronarë të ligjshëm të apartamentit në Rr. “****”, duke e shkëmbyer atë me shumën prej 25.000 eurosh, shumë kjo e përdorur nga subjekti për blerjen e apartamentit tjetër prej 76 m², kompleksi “****”, ap. ***, Shëngjin, Lezhë, si dhe njësinë e shërbimit me sipërfaqe 150 m².

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ana e “****” sh.p.k., rezulton se kjo kompani, me qëllim marrjen e lejes së ndërtimit, ka lidhur marrëveshje noteriale me të gjithë poseduesit e apartamenteve dhe pronarin e truallit ku është ndërtuar godina, Z. P.C, përpara datës 26.11.2009, datë në të cilën është dhënë edhe leja e ndërtimit, ndërsa marrëveshja me subjektin e rivlerësimit është formalizuar më vonë se marrja e lejes së ndërtimit.

Në përfundim të kësaj analize konstatohet se subjekti i rivlerësimit:

(i) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë:

- Apartament me sipërfaqe 76 m², me adresë kompleksi “****”, ap. ***, Shëngjin, Lezhë.
- Njësi shërbimi, plus sipërfaqet e përbashkëta 150 m², në unazën e qytetit Lezhë, Rr. “****”, kati ***.

¹Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji. Në rastet e tjera veprimi juridik është i vlefshëm, por nuk mund të provohet me dëshmitarë.

² Pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qenë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit. Për sendet që përcaktohen në numër, në peshë ose me masë, duhet të bëhet edhe dorëzimi i tyre.

³ Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti, të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat publikë.

(ii) Ka kryer deklarim të rremë mbi të ardhurat e ligjshme, burim i pasurisë së sipërcituar.

4. Autoveturë “Toyota Land Cruiser” e vitit 2012, cilindrata 2980 cc, blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.08.2016, me vlerë 19.500 euro.

Burimi i deklaruar i krijimit:

a. 12.000 euro nga huaja e Z. A.M, sipas kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.08.2016.

b. 4.000 euro nga shitja e autoveturës “Toyota Land Cruiser” e vitit 1998, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.9.2016.

c. kursimet familjare nga të ardhurat gjatë viteve 2015-2016.

Në lidhje me këtë automjet, subjekti ka vënë në dispozicion fotokopje të:

- Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 29.08.2016;
- Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 15.09.2016;
- Kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.08.2016.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2017, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me shkresën nr. *** prot., datë 23.12.2017, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë na informon se Z. A.N ka mjet me targa ***, duke na vënë në dispozicion dhe dosjen e plotë të mjetit.

- Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2017, drejtuar noterit publik, Z. V.M.

Më datë 20.12.2017, me shkresën nr. *** prot., noteri publik, Z. V.M, na vë në dispozicion kopje të kontratës së huas, datë 27.08.2016, me nr. *** rep., nr. *** kol.

- Shkresë nr. *** prot., datë 09.01.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ia delegon për kompetencë Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë.

Me shkresën nr. *** prot., datë 30.01.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë na informon se: *Shtetasi A.N.M është administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., e cila është regjistruar në organet tatimore më datë 16.04.2007; nuk ka detyrime të palikuiduara, por nuk ka dividendë të tërhequr.*

- Dëshmia e Z. A.M, më datë 27.02.2018.

Njoftimi dhe kalimi i barrës së provës

Në përfundim të hetimit administrativ të thelluar, bazuar edhe në deklaratimet dhe provat e depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit, trupa vendosi përfundimin e hetimit dhe kalimin e barrës së provës te subjekti. Duke i dhënë mundësinë ligjore për njohjen me dosjen, subjektit iu vunë në dispozicion rezultatet e këtij hetimi, si më poshtë:

Në lidhje me pasurinë autoveturë “Toyota Land Cruiser”, e vitit 2012, blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.08.2016 ,me vlerë 19.500 euro.

Rezultoni se:

1. Ka një diferencë të pajustificuar në çmim në shumën totale 1.257.510 lekë. Mjeti është importuar në Shqipëri më datë 13.08.2016 dhe i është shitur bashkëshortit të subjektit më datë 29.08.2016.
2. Mjeti që ka pasur në pronësi është shitur më datë 15.09.2016, rreth një muaj më vonë se blerja e mjetit “Toyota Land Cruiser”. Ndërkohë që shuma prej 4.000 eurosh për shitjen e këtij mjeti është deklaruar si burim të ardhurash për blerjen e mjetit “Toyota Land Cruiser”.
3. Referuar lëvizjeve të llogarisë në bankën “Credins” të Z. A.N, nga ana e Z. A.M është derdhur *cash* shuma 120.000 lekë dhe nga ana e bashkëshortes së tij, Znj. A.M, në po të njëjtën llogari, është derdhur shuma 180.000 lekë për shpenzime avokatie.
4. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me mundësinë financiare të shtetasit A.M për dhënien e huas në shumën 12.000 euro.

Arsyetimi ligjor:

Referuar dokumentacionit të procedurës së zhdoganimit të makinës nga ana e shitësit të makinës, Z. R.K, rezultoni se bazuar në “Formularin Import 4”, çmimi i blerjes së mjetit është deklaruar 23.900 euro. Për këtë mjet, bazuar në “Deklaratën Doganore Import 4”, rezultoni se është paguar një shumë detyrimi për zhdoganimin e mallit në vlerën 659.110 lekë. Në total, kostoja e këtij mjeti, pa përfshirë transportin, është 3.909.510 lekë [3.250.400 lekë (23.900 euro konvertuar për 136 lekë) çmimi i blerjes nga shitësi + 659.110 lekë detyrimet doganore].

Nëse i referohemi çmimit të blerjes nga ana e Z. A.N, në vlerën 19.500 euro, konvertuar në lekë 2.652.000, kemi një diferencë të pajustificuar në çmim në shumën totale 1.257.510 lekë. Kjo diferencë në çmim blerje/çmim shitje nuk justifikohet as me kohën e përdorimit të mjetit, i cili është importuar në Shqipëri më datë 13.08.2016 dhe i është shitur bashkëshortit të subjektit më datë 29.08.2016.

Për sa më sipër, lindin dyshime të arsyeshme të një veprimi financiar të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (parimi i fitimit), përderisa shitësi shet me një çmim më të ulët mallin e sapoblerë.

Në lidhje me këtë fakt, subjektit iu kalua barra e provës. Në përgjigjet e depozituara me shkrim, subjekti i rivlerësimit nuk është në gjendje të japë shpjegim për këtë favorizim në çmim, por ajo rreshton një sërë defektesh të kësaj makine, të cilat do të duhej të reflektonin një çmim edhe më të ulët sesa ai i deklaruarit, duke thelluar diferencën midis çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes.

Ndërsa në fjalën e saj në seancë, subjekti deklaroi se arsyeja e blerjes së këtij mjeti është siguria rrugore, pasi për shumë vite i është dashur të udhëtojë për të shkuar në punë në distanca të largëta, ku rreziku i aksidenteve ka ardhur duke u rritur.

Si burim të ardhurash për blerjen e këtij automjeti subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ana e subjektit, rezulton se automjeti që ka pasur në pronësi, është shitur më datë 15.09.2016, rreth një muaj më vonë se blerja e mjetit “Toyota Land Cruiser”, duke të krijuar bindjen mbështetur në prova se deklarimi për burimin e blerjes së mjetit është i rremë, për sa kohë rezulton se në datën 29.08.2016 është paguar çmimi i makinës në shumën 19.500 euro, pra subjekti i dispononte 4000 euro që në momentin e shitjes së mjetit. Në përgjigje të barrës së provës për këtë rezultat të hetimit, më datë 03.04.2018, subjekti sqaron se automjeti që kishin pasur ishte shitur që më 22.07.2016, por aktin e blerjes e kishin nënshkruar më 15.09.2016 dhe, për të vërtetuar këtë fakt, vë sërish në dispozicion të Komisionit një deklaratë noteriale të datës 26.03.2018. Nëpërmjet kësaj deklarate përpiqet të provojë ngjarjet e vitit 2016, sipas së cilës automjeti është marrë në dorëzim më 22.07.2016, por për shkak të angazhimeve personale, si pushime verore, angazhimeve politike për zgjedhjet lokale, etj, kontrata u nënshkrua më 15.09.2016. Por, në kontratën e shitjes së mjetit, të datës 15.09.2016, në paragrafin e pestë të saj, parashikohet se: *“Shitësi dorëzon automjetin dhe blerësi sa më lart e merr në dorëzim në gjendje në të cilën e ka pëlqyer sot, ditën e lidhjes së kësaj kontrate.”*

Pavarësisht shpjegimeve të dhëna, me fakte të krijuara rishtazi, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit në mbështetje të Deklaratës së Pasurisë “Vetting”, rezulton se mjeti që ka pasur në pronësi është shitur më datë 15.09.2016, rreth një muaj më vonë se blerja e mjetit “Toyota Land Cruiser”, duke të krijuar bindjen mbështetur në prova se deklarimi për burimin e blerjes së mjetit është i rremë, për sa kohë rezulton se në datën 29.08.2016 është paguar çmimi i makinës në shumën 19.500 euro, pra subjekti i dispononte 4000 euro që në momentin e shitjes së mjetit. Kjo vlerë prej 4.000 eurosh rezulton e padeklaruar nga subjekti, duke përbërë fshehje të të ardhurave ose të ardhura të krijuara nga burim i paligjshëm.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka përdorur dokumente që përmbajnë të dhëna të rreme/të paverifikueshme, ka kryer fshehje të pasurisë, si dhe ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar burimin e shumës 4.000 euro për blerjen e automjetit.

Si burim kryesor për blerjen e makinës subjekti ka deklaruar huan e marrë nga Z. A.M, në shumën prej 12.000 eurosh. Hetimi dhe analiza e Komisionit është kryer me qëllim vërtetimin e aftësisë huadhënëse të Z. M.

Me shkresë nr. *** prot., datë 30.01.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë na informoi se: Shtetasi A.N.M është administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., e cila është regjistruar në organet tatimore më datë 16.04.2007, nuk ka detyrime të palikuiduara, por nuk ka dividendë të tërhequr.

Referuar shkresës nr. *** prot., datë 25.07.2017, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore drejtuar ILDKPKI-së rezulton se Z. A.M ka një pagën mujore neto në vlerën rreth 29.985 lekë.

Në lidhje me këtë çështje, është pyetur subjekti i rivlerësimit më datë 13.02.2018, i cili është përgjigjur: *“Po, e vërtetë që A.M nuk i ka tërhequr nga dividendët apo nga lekët e punës*

*(aktivitetit), por siç deklaroi ai, i ka pasur gjendje nga kushëriri i tij, A.M (marrë në rrugë bankare), shiko deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.02.2018, si dhe deklaratën tjetër noteriale, bashkëlidhur saj, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.01.2016.”*

Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti na ka vënë në dispozicion një deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.02.2018, një ditë përpara se të përgjigjej për pyetjet e kësaj trupe. Në këtë deklaratë, Z. A.M deklaroi se paratë që i ka dhënë hua Z. A.N nuk i ka pasur të tijat, por ia ka marrë hua kushëritit të tij, Z. A.M, emigrant me dokumente të rregullta në Greqi, me rrugë bankare dhe me deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.01.2016. Kjo hua është dhënë në kushtet e mirëbesimit dhe pa asnjë mjet garancie.

Siç rezulton nga kjo përgjigje, subjekti, në mënyrë të përsëritur, përpiket të vlerësojë veprimet e kryera në vitet e mëparshme me deklarata të reja noteriale. Ajo përpiket të justifikojë shumën prej 12.000 eurosh me një deklaratë noteriale, që vërtetohet nga një deklaratë tjetër noteriale.

Të gjitha këto veprime, pavarësisht se paraqiten nëpërmjet deklaratave të bëra përpara noterit publik, nuk justifikojnë dhe nuk kanë nivelin e provueshmërisë për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave në shumën prej 12.000 eurosh.

Duke qenë se Z. A.M ka marrë hua prej 50.000 eurosh nga Z. A.M në datën 05.01.2018, është e kuptueshme që kjo shumë ka qenë e destinuar për t'u përdorur nga Z. A.M për nevoja të tij. Ndërkohë që subjekti pretendon se 12.000 euro prej këtyre, Z. A.M ia ka dhënë hua, por pa asnjë interes apo përfitim tjetër.

Z. A.M u thirr me cilësinë e dëshmitarit përpara trupës gjyquese, më datë 27.02.2018, ku deklaroi se:

*“[...] A. e kam avokat dhe po merret me një çështje. Ka një çështje të kunatave të mia. Ato kanë pësuar një aksident në qershor, para dy vitesh. Presin të marrin kompensimin dhe ai është avokati i çështjes së këtyre. Unë kam një çështje civile. Ai nuk është direkt avokati im, por është avokati i një prej palët paditëse. Jam unë paditës dhe është një palë tjetër paditëse, A mbron paditësin tjetër. **Nuk kam bërë pagesë në llogarinë e Z. A.N. A.M e kam bashkëshorte. Nuk e di nëse ka bërë pagesë për llogari të Z. A.N. Me A. nuk kam asnjë marrëdhënie. Më ka kërkuar hua dhe i vëllai më ka thënë që, nëse nuk ta likuidon ai, do të ma likuidojë i vëllai. I kam dhënë hua shumën 12.000 euro në cash. Këtë shumë nuk e kisha në bankë, por në kasafortë së bashku me shumën 38.000 euro. Shumën e lekëve që ia kam dhënë Z. A.N ia kam marrë një kushëriti që punon si refugjat. Ia mora atij për qëllime të mia, që të mos prekja bilancin tim. Nga këto ia dhashë A., i kisha në gjendje cash [.....]”.***

Nga ana e Z. M. fillimisht u deklarua se nuk ka kryer asnjë pagesë për llogari të Z. A.N dhe më pas deklaroi se ka paguar 50.000 lekë. Z. M. iu drejtua pyetja: “Si përfundim, ju nuk keni bërë shpenzime avokatie për A.?” Ai deklaroi se “mund të kem bërë rreth 50.000 lekë pagesë për të. Kam bërë për këtë çështjen e këtij tjetri dhe ia dhashë unë”.

Deklarimi i këtij shtetasi nuk është në përputhje me të dhënat e marra nga llogaria bankare e Z. A.N, nga ku rezulton të jetë paguar në total shuma prej 300.000 lekësh.

Referuar lëvizjeve të llogarisë në bankën “Credins” të Z. A.N rezulton se nga ana e Z. A.M është derdhur *cash* shuma 120.000 lekë dhe nga ana e bashkëshortes së tij, Znj. A.M, në po të njëjtën llogari, është derdhur shuma 180.000 lekë për shpenzime avokatie.

Ndërkohë që subjekti, bashkëlidhur me shpjegimet e paraqitura, ka dorëzuar pranë Komisionit, në seancën dëgjimore, edhe dy fatura tatimore, që provojnë të kundërtën e asaj që dëshmitari M. deklaroi para Komisionit. Këto janë fatura tatimore shitjeje nr. ***, datë 05.12.2016, me palë shitëse Z. A.N dhe palë blerëse Z. A.M, me përshkrim “Shërbim avokatie”, në shumën 120.000 lekë me TVSH, si dhe fatura tatimore e shitjes nr. ***, datë 20.12.2016, me palë shitëse Z. A.N dhe palë blerëse Znj. A.M, me përshkrim “Shërbim avokatie”, në shumën 180.000 lekë me TVSH.

Duke qenë se në lidhje me këtë gjetje, subjektit iu kalua barra e provës, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit paraqet mandatarëkëtimin e riprintuar apo nxjerrë nga sistemi i “Credins Bank” më datë 27.03.2018, sipas të cilit citohet “Urdhër xhirim. Urdhërues L.M ose J.M, borxh sipas dokumentit bashkëngjitur nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.01.2016, në shumën 50.000 euro”.

Duke krahasuar të dhënat e këtij mandat arkëtimi me deklarin e Z. M., Komisioni konstaton mospërputhje të plotë. Në deklarin e tij, Z. M. pretendoi se kushëriri i tij, emigrant i rregullt në Greqi, ia ka dhënë këtë shumë dhe i kanë thënë t’ia japë nënës së tyre në Lezhë sa herë të ketë nevojë. Ndërkohë që urdhëruese e kësaj shume në bankë është vetë nëna e kushëririt, Znj. L.M, vërtetuar me certifikatën familjare të vënë në dispozicion nga subjekti.

Në analizë të provave të mësipërme, rezulton se Z. A.M nuk ka aftësi pagueuse për të justifikuar dhënien e një huaje në vlerën 12.000 euro dhe se kontrata e huas është lidhur në mënyrë fiktive. Për më tepër, ai ka reflektuar qëndrim jokonstant në deklaratat e tij të bëra përpara trupës gjyquese, duke vënë në dyshim çdo deklaratë tjetër të tij. Subjekti është në kushtet e deklarin të pamjaftueshëm për dhënien e huas, deklarin të rremë dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me mundësinë financiare të shtetasit A.M për dhënien e kësaj huaje.

Në përfundim të analizës së mësipërme konkludohet se subjekti i rivlerësimit:

(i) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë:

- Autoveturë “Toyota Land Criser” e vitit 2012, cilindrata 2980 cc, blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.08.2016, me vlerë 19.500 euro.

(ii) Ka kryer deklarin të rremë mbi të ardhurat e ligjshme, burim i pasurisë së sipërcituar.

5. Në lidhje me vlerësimin e deklaratave periodike, Komisioni konstatoi se mungon deklarin i shitjes së automjetit me targa ***, si në Deklartin e Pasurisë “Vetting”, ashtu edhe në Deklartin periodike të interesave private të vitit 2008, si dhe kthimi i huas së dhënë në vitin 2007.

Njoftimi dhe kalimi i barrës së provës

Në përfundim të hetimit administrativ të thelluar, bazuar edhe në deklaratimet dhe provat e depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit, trupa vendosi përfundimin e hetimit dhe kalimin e barrës së provës te subjekti. Duke i dhënë mundësinë ligjore për njohjen me dosjen, subjektit iu vunë në dispozicion rezultatet e këtij hetimi, si më poshtë:

Rezulton se:

1. Nuk është deklaruar nga ana e subjektit shitja e mjetit me targa *** për shumën 200.000 lekë në vitin 2008, si në Deklaratën periodike të interesave private të vitit 2008, ashtu edhe në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”.
2. Në Deklaratën periodike të vitit 2007 është deklaruar se i ka dhënë hua shtetasit P.N, kunati i subjektit të rivlerësimit, shumën prej 300.000 lekësh. Në asnjë nga deklaratat periodike të viteve në vazhdim, por dhe në Deklaratën e Pasurisë “Vetting” nuk rezulton të jetë deklaruar për kthimin e kësaj shume, si dhe është mohuar fakti i dhënies së kësaj huaje, në përgjigje të pyetësorit të dytë të bërë nga ana e Komisionit.

Arsyetimi ligjor:

Në lidhje me deklaratat periodike, konstatohet se në Deklaratën e interesave private të vitit 2003 subjekti ka deklaruar se bashkëshorti ka në pronësi një makinë autoveturë “Golf 3”, me vlerë 400.000 lekë. Kjo makinë nuk rezultonte të ishte deklaruar ndër vite, nëse ishte shitur apo ndryshuar pronësia në format e parashikuara nga ana e Kodit Civil dhe, për rrjedhojë, të ishte deklaruar në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”.

Me shkresë nr. *** prot., datë 25.01.2018, i jemi drejtuar DPSHTRR-së për të marrë informacion se cili ishte pronari aktual i kësaj makine.

DPSHTRR, me shkresë nr. *** prot., datë 02.02.2018, na informon se kjo makinë rezulton në emër të një shtetasi tjetër. Në vijim të kësaj shkrese, me shkresë nr. ***, datë 16.02.2018, DPSHTRR na vë në dispozicion dosjen e mjetit, nga ku rezulton se më datë 21.05.2008 nga ana e Z. A.N është shitur ky mjet me kontratë shitjeje nr. *** rep., dhe nr. *** kol., për shumën 200.000 lekë.

Të ardhurat për shitjen e këtij mjete nuk janë deklaruar në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2008, si dhe në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: *“Është i vërtetë konstatimi Juaj, që nuk është deklaruar shitja e këtij automjeti. Kjo ka ardhur vetëm për arsye se e kemi harruar atë dhe për asnjë qëllim tjetër.”*

Në Deklaratën periodike të vitit 2007 rezulton një hua dhënë Z. P.N në vlerën 300.000 lekë, kursyer nga pagat, hua kjo e padeklaruar si e kthyer.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar më datë 31.01.2018, subjekti deklaroi se *“Jo, në dijeninë time, as unë dhe as bashkëshorti im nuk kemi dhënë hua në shuma të tilla mbi 100.000 lekë”*.

Ndërsa në shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore, subjekti deklaroi se: *“Edhe ky konstatim i Juaj është i vërtetë, se nuk është deklaruar dhënia hua e shumës kumatit tim, edhe marrja e tyre, është e vërtetë. Por, në momentin që në P/V 2008 kemi deklaruar kursime nga viti 2007, në shumën 300.000 mijë lekë, kemi menduar se kuptohet që janë kthyer dhe kjo s’është deklaruar më, as ne nuk e kemi kujtuar më për ta saktësuar, pasi ka kaluar një kohë e gjatë. Por fakt është që ajo shumë është kthyer një vit më pas, pra në vitin 2008, kur edhe është deklaruar si shtesë (likuiditet) nga kursimet e vitit 2007.”*

Për sa më sipër, Komisioni konstaton se jemi në kushtet e deklarimit të rremë, pasi subjekti në Deklaratën periodike të vitit 2007 ka deklaruar se i ka dhënë hua shumën 300.000 lekë Z. P.N.

Këto fakte na çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani:

- **Ka kryer fshehje të pasurisë në shumën prej 200.000 lekësh;**
- **Ka kryer deklarim të rremë në lidhje me huadhënien.**

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi administroi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ftoi dhe dëgjoi në seancë subjektin e rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, shqyrtoi dhe analizoi si më lart, trupa gjykuese konkludon se:

Subjekti i rivlerësimit, Besa Rexhep Nikëhasani, rezulton të ketë deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të:

Apartament banimi në Shëngjin, Lezhë,

me burim të pajustificuar, subjekti nuk ka pasur asnjëherë dokument pronësie për apartamentin në Rr. “****”, të cilin pretendon ta ketë shkëmbyer me shumën 25.000 euro;

Njësi shërbimi 150 m² në Rr. “**”, Lezhë,**

me burim të pajustificuar, subjekti nuk ka pasur asnjëherë dokument pronësie për apartamentin në Rr. “****”, të cilin pretendon ta ketë shkëmbyer me këtë njësi shërbimi;

Apartament banimi në Rr. “**”, Tiranë,**

me burim të pajustificuar, në shumën 2.029.700 lekë;

Autoveturën tip “Toyota Land Cruiser”,

me burim të pajustificuar në shumën 2.164.320 lekë, pasi rezulton se Z. A.M nuk ka aftësi paguese për të justifikuar dhënien e një huaje në vlerën 12.000 euro dhe subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar burimin e shumës 4.000 euro për blerjen e automjetit.

Subjekti i rivlerësimit, Besa Rexhep Nikëhasani, rezulton se ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sepse:

- Deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin. Subjekti në mënyrë të përsëritur pranon të ketë gabime dhe pasaktësi në deklarime, duke i konsideruar ato *lapsuse*;
- Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pasuritë që ka në pronësi, mungesë të dokumentacionit ligjor për pronësinë e këtyre burimeve të pretenduara;
- Ka kryer fshehje të pasurisë në shuma të vogla;
- Ka kryer deklaram të rremë në mënyrë të përsëritur, duke u përpjekur të justifikojë veprimet e viteve të mëparshme me deklarata noteriale të sapohartuara.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe në nenin 61, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit e rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, prokurore pranë Prokurorisë së Apelit Shkodër.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

SUELA ZHEGU

Kryesuese

PAMELA QIRKO

Anëtare

GENTA TAFI (BUNGO)

Relatore

OLSIDA GOXHAJ

Sekretare gjyqësore

U shpall në Tiranë, më datë 20.04.2018.